

Akademia e Drejtësisë
Akademija Pravde
Academy of Justice

Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)
 - * Aktivitetet Tjera

Shkurt 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Krimi i organizuar

Më 01 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Krimi i organizuar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për luftimin e krimit të organizuar, veprimet që duhet ndërmarrë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë me qëllim që të zbatohen në mënyrë efektive mekanizmat përkatës.

Ky trajnim trajtoj krimin e organizuar si formë e kriminalitetit që kryhet nga një grup i strukturuar, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt ose tërthorazi të dobisë pasurore apo financiare.

Krimi i organizuar kërcënon seriozisht zhvilli-

min e demokracisë dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit.

Trajnimi u fokusua kryesisht në elaborimin e kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare që rregullon këtë fushë, përkufizimin ligjor të krimit të organizuar, si dhe elementet identifikues të kësaj vepre penale.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminim

Më 02 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin nga fusha e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me temë “Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos-diskriminimin”.

Trajnimi u realizua me qëllim që të kontribuoj në avancimin e njohurive profesionale të përfituesve në qartësimin dhe zbrëthimin e kompleksitetit të legjislacionit për mos diskriminimin në Kosovë, si dhe qasjen dhe trajtimin e barabartë të komunitetit LGBT nga ana e gjyqësorit.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaborua korniza

ligjore vendore që rregullon këtë fushë, parimi i trajtimit të barabartë, konceptet kyçe të diskriminimit, kategoritë e diskriminimit, si dhe fushat më të prekura nga kjo dukuri.

Po ashtu gjatë trajnimit u realizuan aktivitete ndërgjegjësimi për diversitet, paragjykime, mos-diskriminim dhe barazi.

Trajnimi u zhvillua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive për vështirësitë në aplikimin e drejtë të legjislacionit mbi mos-diskriminim.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë

Më 03 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës, ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte elaborimi i hollësishëm i ndryshimeve të legjislacionit vendor për të drejtën e pronësisë dhe standardeve të përcaktuara me protokollin 1 të KELDNJ-së.

Trajnimi kishte për synim që përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimeve grupore, të ofrohen alternativa për problemet dhe vështirësitë praktike në mbrojtjen e të drejtës së pronësisë në përgjithësi.

Gjatë këtij trajnimi u shtjelluan në mënyrë të hollësishme e drejta e pronësisë, paditë për mbrojtjen e pronësisë, padia e rivendikimit, padia negatorë dhe padia publiciane. Me theks të veçantë u trajtua Protokollin 1 i Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.

Trajnimi u realizua me metoda të kombinuara, përmes ligjërimit të pjesëshëm teorik, diskutimeve aktive me pjesëmarrësit të cilët paraqitën sfidat dhe problemet nga këndvështrimi i tyre lidhur me temën.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor dhe të apelit.



Risitë e Ligjit për Falimentim

Më 07-09 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të PTV-së, realizoi trajnimin me temë “Risitë e Ligjit për Falimentim”.

Qëllim i këtij trajnimi ishte elaborimi i Ligjit të ri për falimentimin si dhe identifikimi dhe njoftimi i pjesëmarrësve me ndryshimet e ligjit të ri për falimentimin.

Në fokus të këtij trajnimi ishin procedurat e falimentimit që kanë ndryshuar me ligjin e ri, fushëveprimi i ligjit, parimet, procesi i aplikimit për falimentim, falimentimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pasuria e falimentimit dhe kërkesat e kreditorëve.

Gjatë trajnimit në veçanti u elaboruan proce-

durat e përshpejtuara, fillimi, hapja e rasteve dhe pasojat, kërkesat e kreditorëve, procesi i riorganizimit, procesi i likuidimit dhe falimentimi ndërkombëtar.

Trajnimi u zhvillua në atë formë, që përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, u trajtuan të gjitha dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, me fokus në ndryshimet e ligjit të ri për falimentimin dhe efektet e tij.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional të nivelit themelor



Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës Sesioni I

Më 10-11 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, ka realizuar trajnimin lidhur me temën e lartpërmendur.

Ky sesion trajnues kishte për qëllim elaborimin e legjislacionit pozitiv, zhvillimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend, rreth procedurave dhe fazave të prokurimit publik si dhe identifikimin e indikatorëve të korrupsionit që lidhen me prokurimin publik.

Fillimisht në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtua legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë, ndryshimet legjislative, procedurat e prokurimit publik dhe mënyra e funksionimit të platformës së prokurimit publik elektronik.

Në këtë kontekst u elaboruan rregullat për specifikimet teknike dhe dosja e tenderit, përpilimi i dosjes së tenderit, procesi i

vlerësimit të një tenderi, si dhe njoftimi, nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratave publike.

Më tej, trajnimi u fokusua në elaborimin e skemave korruptive dhe problemeve të ndërlidhura me mashtrim, skemat e kurdisjes së ofertave si dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e këtyre veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik.

Gjatë fazës së fundit të këtij sesioni, u diskutua planifikimi i hetimit, përmbajtja e planit të hetimit, ndjekjes, identifikimit të burimeve të informacionit si dhe rëndësia e krijimit të një strukture të hetimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit Themelor dhe të Apelit si dhe prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës.



Procedurat alternative

Më 15 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Procedurat alternative”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin në praktikë të procedurave alternative në procedurën penale si dhe trajtimi i procesit të zhvillimit të institutit të Negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Ky trajnim trajtoj procedurat alternative të cilat kanë pësuar disa ndryshime në krahasim me kodin e mëparshëm të procedurës penale, të cilat ofrojnë mundësi për zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve penale.

Me rastin e këtij trajnimi u vu në pah dobishmëria e procedurave alternative, veça-

nërisht për të rritur efikasitetin dhe për të krijuar një sistem të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale.

Gjithashtu, gjatë trajnimit janë trajtuar çështja e rëndësisë së procedurave alternative si mundësi më e shpejtë në zgjidhjen e rasteve penale, si diversioni dhe pezullimi i përkohshëm i procedurës, ndërmjetësimi dhe negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që i hasin gjatë praktikës gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje

Më 16 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të PTV-së realizoi trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësve t’iu mundësoj njohjen me dhunën në familje, pasojat e dhunës në familje, kush mund të kërkojë lëshimin e urdhrit mbrojtës, procedurat gjyqësore për vendosje sipas kërkesës si dhe masat e kohëzgjatjes së tyre.

Gjatë këtij trajnimi nga pjesëmarrësit u paraqitën dilemat dhe paqartësitë rreth çështjeve për të cilat gjyqtarët kanë pengesa gjatë shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje si dhe të zbatojnë në mënyrë precize dispozitat ligjore lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër

mbrojtje.

Po ashtu u diskutuan procedurat për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Trajnimi kishte për synim që përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimeve grupore, të ofrohen alternativa për problemet dhe vështirësitë praktike në lidhje me mbrojtjen gjyqësore në rastet e dhunës në familje.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.



Hetimi i krimeve financiare

Më 22 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Hetimi i krimeve financiare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me veprimet parandaluese që duhet ndërmarrën për të luftuar ndikimin e krimit financiar, si dhe hartimin e strategjive përkatëse për luftimin e krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe evazionit fiskal.

Në fokus të trajnimit ishte trajtimi i krimeve financiare si pjesë e krimeve më serioze, që kanë për qëllim që ta atakojnë zhvillimin ekonomik të shoqërisë.

Gjithashtu janë trajtuar format e kriminalitetit si korrupsioni me të gjitha karakteristikat, pastrimi i parave, evazionet fiskale, prokurimi publik, veprat penale që ndërlidhen me krimet financiare dhe pasojat e shkaktuara brenda vet sistemit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë gjatë punës së tyre të përditshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Më 24-25 shkurt 2017, Akademia e Drejtësisë ka organizuar trajnimin me temë "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror".

Qëllimi i trajtimit ishte zbatimi i drejtë i legjislacionit nga ana e gjyqësorit për çështjet që i referohen procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në kuadër të këtij trajnimi, fillimisht, u elaborua adoptimi si formë e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve, nocioni, kushtet dhe nevojat për themelimin e adoptimit, procedura gjyqësore e themelimit të adoptimit si atij vendor po ashtu edhe procedura gjyqësore e adoptimit me element ndërkombëtar.

Gjithashtu u trajtuan dhe bashkëpunimi i gjykatës dhe i organit të kujdestarisë në procedurën e adoptimit si dhe vendimet e gjykatës për adoptimin.

Më tej, punimet u fokusuan kryesisht në temat

lidhur me vendosjen e fëmijës në familjen tjetër si formë e organizuar shoqërore e përkujdesjes ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror dhe roli i Qendrës për Punë Sociale në këtë aspekt, si në rastet e vendosjes së fëmijës në familjen tjetër nga ana e prindërve po ashtu dhe në rastet e vendosjes së organizuar të fëmijës në familjen tjetër.

Kujdestaria si institut me karakter shoqëror, organi i kujdestarisë si organ kompetent për mbrojtje të drejtave të fëmijëve dhe mënyrat e ushtrimit të kujdestarisë, ishin temat që po ashtu u shtjelluan.

Në këtë pjesë po ashtu u diskutua në lidhje me ushtrimin, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e të drejtës prindërore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Trajnim praktikë i prokurorëve të sapoemëruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

Më 01 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për prokurorët e sapoemëruar të shtetit, ka realizuar trajnimin praktik në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Trajnimi kishte për qëllim që prokurorët e sapoemëruar të njoftohen me rolin, mandatin dhe funksionet e Gjykatës Kushtetuese së Kosovës.

Në kuadër të këtij trajnimi, fillimisht u trajtuan parimet kryesore në bazë të të cilave funksionon Gjykata Kushtetuese, struktura dhe raporti i saj me ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin e rregullt. Po ashtu, u shtjellua edhe koncepti dhe zbatimi i kontrollit incidental në Gjykatën Kushtetuese.

Më tej, në mënyrë të hollësishme u elaborua

puna praktike e gjykatës, funksionimi i saj i brendshëm, palët e autorizuara, procesi i pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të ndryshme të paraqitura për trajtim para kësaj gjykate si dhe nivelet e vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe disktimeve interaktive, me ç' rast prokurorët e sapoemëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Aktivitetet e realizuara në PTF- shkurt 2017

Gjatë muajit shkurt 2017, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, janë zhvilluar aktivitete trajnuese dhe kanë përfshirë trajnimin teorik dhe atë praktikë.

Në kuadër të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar 8 sesione trajnuese nga nën-moduli “KEDNJ- legjislacioni për të drejtat e njeriut”, ku ndër çështjet kryesore të trajtuara janë: Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 2, neni 4 i Protokollit 7, neni 5, neni 6.1, 6.2 dhe 6.3 dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu në përmbushje të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar edhe 8 sesione trajnuese nga nën-moduli “Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale”.

Në kuadër të këtij nën-moduli janë shtjelluar: procedura paraprake-parashtrimi i kallëzimit penal, fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve, pezullimi dhe pushimi i hetimeve, zgjerimi dhe rifillimi i hetimeve, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, dëshmitarët dhe procedimi i tyre gjatë fazës së hetimeve, mundësia hetuese e veçantë, si dhe ngrirja dhe

sekuestrimi si veprim procedural gjatë fazës së hetimeve.

Gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese, u aplikua një metodologji e kombinuar duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive, ku prokurorët e sapoemëruar ngritën edhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në prokuroritë përkatëse.

Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen e rasteve të ndryshme.

Në kuadër të trajnimit praktikë në prokurori, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.

Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktikë trajnues, prokurorët e sapoemëruar kanë vijuar trajnime në këto institucione: Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Agjencinë kundër Korrupsionit.



Trajnimi praktikë i prokurorëve të sapoemëruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimit Civil të Kosovës

Më 08 shkurt 2017, në kuadër të trajnimeve praktike në institucionet jo gjyqësore, IGJK ka realizuar trajnimin për prokurorët e sapoemëruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimit Civil të Kosovës.

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi konsistonte në faktin që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohurit e tyre duke u njoftuar për së afërmi me rolin, përgjegjësitë dhe punën praktike të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjatë trajnimit u elaborua korniza ligjore në bazë të të cilës funksionon Këshilli dhe ushtron mandatin e tij ligjor, kompetencat e Këshillit, shqyrtimi i ankesave, procedura dhe format e vendimmarrjes në Këshill.

Më tej u shtjelluan afatet dhe veprimet e organeve të punësimit në raport me zbatimin e vendimeve të Këshillit, personat përgjegjës për zbatim të këtyre vendimeve si dhe procedura e njoftimit dhe mos zbatimi i vendimeve të Këshillit, sfidë kjo e cila u potencua si problem aktual i vazhdueshëm.

Trajnimi ishte interaktiv në çdo fazë të tij, me diskutime të shumta për raste praktike dhe sfidat aktuale në fushën e shërbimit civil, të cilat u zhvilluan nga ana e prokurorëve të sapoemëruar dhe zyrtarëve të Këshillit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnim praktikë i prokurorëve të sapoemëruar në Agjencinë kundër Korrupsionit

Më 22 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka realizuar trajnimin praktikë, për prokurorët e sapoemëruar të shtetit, në Agjencinë kundër Korrupsionit.

Trajnimi synonte që prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohurit e tyre rreth mandatit ligjor, përgjegjësi dhe rolit që luan Agjencia kundër Korrupsionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Fillimisht në kuadër të këtij trajnimi u elaborua në mënyrë të përgjithshme misioni dhe struktura organizative e Agjencisë kundër Korrupsionit, baza ligjore mbi të cilën funksionon ky institucion si dhe sfidat aktuale me të cilat bal-

lafaqohet në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj. Më tej në mënyrë të hollësishme, u trajtuan: procesi i hetimeve paraprake, deklarimi i pasurisë dhe i dhuratave, konflikti i interesit dhe roli i Agjencisë në parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Trajnimi ishte interaktiv në çdo fazë të tij, me ç'rast prokurorët e sapoemëruar kishin mundësinë të paraqesin dhe diskutojnë çështje me interes me të cilat ata mund të ballafaqohen në praktikën e tyre me lëndët e kësaj natyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të shtetit, gjenerata VI-të e PTF-së



Aktivitetet Tjera

Didaktika gjyqësore

Me 23 shkurt 2017, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit "Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor" i financuar nga BE, realizoi një punëtori për trajnues me temë "Didaktika gjyqësore".

Qëllimi i realizimit të punëtorisë ishte përgatitja e një grupi të trajnuesve që do të përdoren për realizimin e aktiviteteve për trajnuesit e ardhshëm rreth përdorimit të metodave dhe teknikave më bashkëkohore të trajnimit.

Gjatë punëtorisë rëndësi ju kushtua trajnimit të bazuar në kompetencë, zbatimit të metodologjisë bashkëkohore dhe përdorimit të teknikave më të avancuara gjatë trajnimit, strukturës dhe dizajnit të programit për Trajnimin e Trajnuesve, trajnimeve për mentorë, si dhe përgatitjes së materialeve trajnuese.

Me tej u shtjellua intensiteti i të mësuarit, metodat e avancuara të trajnimit dhe efikasiteti i këtyre metodave.

Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit janë ndarë në dy grupe. Grupi i parë ka pasur për fokus integrimin e teorisë dhe praktikës në programin trajnues veçanërisht në Programin e Trajnimit Fillestar, ndërkaq grupi i dytë në fokus kishte programin dhe strukturën e trajnimit për trajnues dhe sigurimin e cilësisë së trajnimeve.

Çështjet për të cilat janë diskutuar në grupe do të jenë në fokus në punëtoritë e radhës me qëllim të përmirësimit të cilësisë së programeve trajnuese.

Kjo punëtori u realizua nga ekspert ndërkomëtar të fushës së trajnimeve gjyqësore në mbështetje të stafit të IGJK-së.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin gjyqtarë, prokurorë, të gjithë trajnues të IGJK-së.



Instituti Gjyqësor i Kosovës transformohet në Akademi të Drejtësisë

Më 24 shkurt 2017, ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 05/L-95 për Akademinë e Drejtësisë. Me këtë ligj Instituti Gjyqësor i Kosovës transformohet në Akademi të Drejtësisë.

Akademia e Drejtësisë është institucion publik i pavarur, dhe mandat kryesor ka trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimin e personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin.

Sipas ligjit, Akademia e Drejtësisë ka këto funksione:


- harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave

të institucioneve kompetente;

- zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;

Akademia e Drejtësisë si trashëgimtare e Institutit Gjyqësor të Kosovës, do të vazhdojë organizimin e aktiviteteve siç është përcaktuar me programin e punës dhe programin e trajnimeve si dhe do të zbatohen të gjitha aktet normative deri në nxjerrjen e akteve siç është përcaktuar me ligj.

Për të gjitha ndryshimet tjera të gjithë të interesuarit do të njoftohen me kohë nëpërmjet web faqes <https://ad.rks-gov.net/> apo edhe formave tjera të komunikimit.



Akademia e Drejtësisë
Akademija Pravde
Academy of Justice

<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**